



Nr. _____

Shkup, _____ 2022

Në bazë të nenit 55 paragrafi 2 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, drejtori i Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

R R E G U L L O R E

Për tarifata e paguara nga Arkivi Shtetëror gjatë organizimit dhe zhvillimit të trajnimeve

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e tarifave për honorarët e paguar nga Arkivi Shtetëror në trajnimin për ngritjen profesionale dhe aftësimin e punëtorëve që punojnë në punë në zyrë dhe punë arkivore për poseduesit e materialit arkivorë ose personat e papunë që dëshirojnë të pajisen me certifikatë për punë në zyrë dhe punë arkivore.

Neni 2

Arkivi Shtetëror, në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, pika 17, të Ligjit për material arkivorë, organizon zhvillimin profesional dhe aftësimin e punëtorëve që punojnë në zyrë dhe punë arkivore tek poseduesit, për të cilat paguan një tarifë nga mbajtësit në bazë të kontratës të lidhur në përputhje me Tarifën për tarifata në Arkivin Shtetëror të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Në bazë të së njëjtës tarifë, Arkivi Shtetëror ofron trajnime për personat e papunë që dëshirojnë të pajisen me certifikatë për punë arkivore dhe punë në zyrë.

Neni 3

Baza për llogaritjen e kompensimit të mentorit që e zhvillon trajnimin është paga mesatare mujore neto për punëtor të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak.

Neni 4

Masa e kompensimit për shpenzimet e punës për mentorin që është punonjës në Arkivin Shtetëror për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve përcaktohet në bazë të numrit të personave që ndjekin trajnimin:

- Për 1 (një) deri në 5 (pesë) persona që ndjekin trajnimin (5%) të bazës.



- Për trajnime në grup deri në 10 (dhjetë) persona që ndjekin trajnimin nga (10%) të bazës.
- Për organizimin dhe kryerjen e trajnimeve në grup për më shumë se 10 persona për degë tek mbajtësit të materialit arkivor (20%) nga baza.

Neni 5

Pagesa e tarifës së trajnimit bëhet nga përcaktimi për shërbime kontraktuale nga zhirollogaria e jashtëzakonshme e Arkivit Shtetëror a më parë të lidhur një marrëveshjeje autorit me mentorin që është i angazhuar në organizimin dhe realizimin e trajnimit bazuar në një raport me shkrim mbi trajnimet e përfunduara.

Pagesa bëhet në shumën neto përmes agjencive autoriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut me tatimin personal të paguar, në bazë të kontratës së autorit dhe faturës së dorëzuar.

Përktheu: Blerta Emini
Lektoroi: Axhire Sinani

Drejtor,
Dr.Emil Krsteski